

SUEDIA ËSHTË FTOHUR. KA ARDHUR KOHA PËR NJË POLITIKË MË TË NGROHTË.

Suedia është një vend fantastik. Këtu shumë njerëz kanë arritur të realizojnë ëndrrat e tyre. Ne kemi vazhduar të pranojmë sfidat e të ardhmes së afërt. Por gjatë viteve të fundit, Suedia është ftohur. Grupimet dhe racizmi janë lejuar të shtohen. Diferenca e kushteve financiare midis meshkujve dhe femrave po rritet. Politika i është shmangur përgjegjësimit për njerëzit dhe mjedisin. Ne e dimë se një shtet që heq dorë nga të qenit fantastik për të gjithë, së shpejti nuk do të jetë më fantastik për askënd. Prandaj, ka ardhur koha për një politikë më humane dhe më të ngrohtë - ka ardhur koha për një qeveri të re.

Ndryshimet klimatike përbëjnë sfidën më të madhe të ditëve të sotme. Teksa udhëheqësit botërorë do të takohen në Paris, në dhjetor të vitit 2015, për të diskutuar çështjet klimatike, Suedia duhet të jetë në gjendje të tregojë se marrja e vendimeve që reduktojnë emetimet në nivele të përballueshme është e mundur. Suedia do të jetë një vend modern ekzemplar dhe frymëzim. Bota nuk mund të përballojë një politikë klimatike ku shtetet e ndryshme thjesht presin nga njëri-tjetri, në vend që të guxojnë të jenë të parët. Politika duhet të jetë më e ngrohtë. Dhe jo klima.

Suedisë i nevojiten vende të reja pune, por "linja e punësimit" të Aleancës nuk e ka ulur papunësinë. Përkundrazi, jeta është vështirësuar dhe ftohur shumë me tepër për të gjithë ata që humbën vendin e punës ose u prekën nga sëmundje. Ne duam të investojmë në punime për përmirësimin e kushteve klimatike - në trena që punojnë në orarin e duhur, në rindërtimin e periferive dhe në banesa të pajisura me sisteme energjetike efikase. Deri në vitin 2018, më shumë njerëz duhet të punësohen dhe rinisë duhet t'i jepet mundësia të gjejë një rrugëzgjdhje për të studiuar dhe punuar. Kjo është një politikë më humane dhe më e ngrohtë.

Të gjithë nxënësit duhet të jenë të lumtur kur shkojnë në shkollë. Shumë persona do të jenë mësues të zjarrtë dhe të gjithë ata persona që punojnë nëpër shkollë do të kenë kohë për të ushtruar profesionin e tyre dhe njëkohësisht për të përmbushur nevojat krijuese. Nuk duhet të ekzistojnë shkolla të mira dhe shkolla të këqija - niveli i shkollave duhet të jetë i lartë dhe kudo i njëjtë. Deri në vitin 2018, shumë më tepër persona do të zgjedhin të trajnohen si mësues, mësuesit do të kenë kohë për të ushtruar profesionin e tyre dhe nxënësit do të marrin ndihmën e duhur në kohë. Politikës së ftohtë me më shumë burokraci dhe gjuetisë së fitmeve ne i përgjigjemi me politikë të ngrohtë, me më shumë personel dhe më shumë kohë për çdo nxënës. Kthejuni nxënësve mësuesit e tyre.

Ne jemi të bindur se është më se e mundur që Suedia të shndërrohet në të ardhmen tonë të përbashkët dhe që nuk na ndan në varësi të vendit nga vijmë, pamjes së jashtme, besimeve, gjinisë, moshës apo pamjes së familjes. Pas tetë vjetësh me Aleancën, më në fund ka ardhur koha për një qeveri të re dhe një politikë më të ngrohtë

Mund të angazhoheni në fushatën elektorale në volontar.mp.se dhe të anëtarësoheni në Partinë e Gjelbër Suedeze nëpërmjet mp.se/bli-medlem

Mirë se erdhët!

“Çështjet klimatike lidhen me botën të cilën dëshirojmë të trashëgojnë fëmijët dhe nipërit e mbesat tona. Emetimet duhet të ulen urgjentisht, por ne mund t’ia dalim mbanë. Kjo arrihet nëpërmjet përdorimit të energjisë me zgjuarsi, trena dhe mjete transporti moderne dhe shoqëri abuzuese bli-e-hidh. Ne mund ta bëjmë Suedinë shembull global të përgjegjshmërisë dhe të udhërrëfyesit ideal.”

Åsa Romson

Ne duam:

- që Suedia të drejtojë në nivel ndërkombëtar punën për dorëzimin e një planeti më të mirë tek fëmijët tanë
- të garantojmë se zgjedhja e kushteve më të mira mjedisore do të jetë gjithmonë zgjedhja më e mirë dhe më e lirë. Udhëtimi me tren duhet të jenë më i lirë se ai me aeroplan dhe më i shpejtë se ai me makinë
- të investojmë në vende të reja pune që lidhen me mjedisin - trena dhe autobusë, energji e rinovueshme, restaurim i banesave sipas ”programit një milion”, turizmi ekologjik, riciklimi dhe.

“Djaloshi që ulet në fund të klasës dhe që është dorëzuar tashmë ka nevojë për një mësues që ka kohë dhe që beson tek ai në veçanti. Dhe vajza që ia ka besuar imazhin e vetvetes notave të larta, rezultateve maksimale në shkollë të mund të shohë vetveten në veçanti, dhe jo të fshehur pas notave, provimeve dhe rezultateve në shkollë. Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të shkojnë në shkollë të lumtur!”

Gustav Fridolin

Ne duam:

- që të shtohet numri i qytetarëve që dëshirojnë të bëhen mësues. Mësimdhënia duhet të konsiderohet si një prej profesioneve tona më të rëndësishme. Prandaj fondet e qeverisë duhet të përdoren për të rritur pagat e mësuesve
- mësuesit duhet të kenë më shumë kohë në dispozicion për të ushtruar profesionin e mësuesit. Ne duam të reduktojmë burokracinë për mësuesit dhe të shtojmë numrin e personelit nëpër shkolla
- nxënësit të jenë të lumtur në shkollë. Duhet të ketë akses më të mirë në shërbimin shëndetësor të nxënësve dhe nivel më të lartë kulturor nëpër shkolla.

Lexoni më shumë rreth politikës tonë në manifestin tonë të zgjedhjeve ose në mp.se.

Në 14 shtator ju mund të bëheni pjesë e modernizimit të Suedisë.